

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

Pml.nr.100/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKAT SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Valdete Daka, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejjini Simnica, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit D. D., për shkak të veprës penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 173, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.8., lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, 2024:024245 të datës 25.01.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.DKR.nr.105/2024 të datës 01.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 14.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtësit të pandehurit D. D. për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, 2024:024245 të datës 25.01.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.DKR.nr.105/2024 të datës 01.02.2024.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin 2024:024245 të datës 25.01.2024, të pandehurit D. D., ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 173, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.8., lidhur me nenin 28 të KPRK-së, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi do t'i zgjasë deri më datë 24.03.2024. Të pandehurit paraburgimi iu është vazhduar konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pikat 1.2.1. e 1.2.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PN1.DKR.nr.105/2024 të datës 01.02.2024, e ka refuzuar si e pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit D. D., avokati Fitim Shabani, për shkak të shkëljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkëljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën, të anulojë aktvendimet e kundërshtuara, ashtu që të pandehurit t'ia ndërpres masën e paraburgimit dhe i njëjti të mbrohet në liri, apo t'i caktoj masën e dorëzarisë, masën e ndalimit për t'iu afruar personit ose vendit të caktuar, masën e arrestit shtëpiak, ose lëndën ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.III.nr.41/2024 e datës 13.02.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1., lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit është e pabazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit në kërkesën e tij pretendon se gjendja faktike e përshkruar në aktvendimet e kundërshtuar nuk i përgjigjen gjendjes reale se çka realisht kishte ndodhur ditën kritike, rrjedhimisht kemi të bëjmë me mos vërtetimin e dyshimit të bazuar i cili është parakusht për caktimin dhe vazhdimin e paraburgimit. Gjithashtu, nuk janë plotësuar kushtet ligjore konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pikat 1.2.1. e 1.2.3. të KPP-së, ngase nuk ekziston rreziku i ikjes, ngase i mbrojturi i tij është dorëzuar vullnetarisht në polici gjë që rrëzon arsyetimin e gjykatës se mund t'i shmanget organeve të drejtësisë, ndërsa vetëdorëzimi i të pandehurit në këtë rast e bënë të qartë faktin se nuk ekziston asnjë tendencë kundrejt përsëritjes së ndonjë veprë penale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryerës i veprës penale për të cilën dyshohet, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat tjera të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, për vazhdimin e paraburgimit. Andaj, kjo gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2., pika 1.2.1. të KPP-së, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale duke pasur parasysh faktin se vepra penale për të cilën dyshohet është e natyrës së rëndë, për të cilën, nëse i njëjti shpallet fajtor, parashihet dënim mjaft i lartë, si dhe fakti se i pandehuri për një kohë ka qenë në arrati, lë për të besuar se me gjetjen e tij në liri i njëjti do të mund të arratiset me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, e në këtë mënyrë do ta pamundëson zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Gjithashtu kjo gjykatë, vlerëson se drejtë është konstatuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pika 1.2.3. të KPP-së, për të pandehurin, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, ku i pandehuri pas përgatitjes paraprake për motive të hakmarrjes ka tentuar që ta privojë nga jeta tani të dëmtuarin A. T., ekziston rreziku se i njëjti do të mund ta përfundojë veprën penale apo ta përsërisë të njëjtën, andaj vazhdimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhjen normale të procedurës penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 171 të KPP-së, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.100/2024, më datë 14.02.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetare e kolegjit,  
Mejreme Memaj